

VENDIM
Nr. 295, datë 22.5.2014

**PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
MISSIONIN HUMANITAR PËR PËRBALLIMIN E GJENDJES SË KRIJUAR NGA PËRMBYTJET NË
BOSNJË-HERCEGOVINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, pika 1, shkronja “ç” e 9, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11, të nenit 14, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin humanitar për përballimin e gjendjes së krijuar nga përmbytjet në Bosnjë-Hercegovinë.

2. Misioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të jetë angazhimi me forca dhe mjete për përballimin e gjendjes së krijuar nga përmbytjet në Bosnjë-Hercegovinë.

3. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë të marrin pjesë në këtë mision me 10 (dhjetë) persona, 1 (një) kamion, 1 (një) minibus dhe 2 (dy) motobarka.

4. Ministria e Mbrojtjes të përballojë shpenzimet për:

a) akomodim;

b) ushqim;

c) dietë ditore për vështirësi shërbimi, në masën 3 000 (tre mijë) lekë;

ç) sigurimin e jetës së personelit dhe të mjeteve;

d) siguracion shëndetësor;

dh) mbështetje shëndetësore;

e) shërbim telefonik;

ë) karburant;

f) transportin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disiplinore;

g) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen dhe kryerjen e operacionit.

5. Statusi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të jetë ai i përcaktuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për statusin e forcave të tyre, bërë në Londër, më 19 qershor 1951, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10101, datë 26.3.2009.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama